

SHTRESIMET KOHORE DHE REFLEKTIMET HAPËSINORE NË ROMANIN "VDEKJA MË VJEN PREJ SYVE TË TILLË" TË REXHEP QOSJES

TEMPORAL LAYERS AND SPATIAL REFLECTIONS IN THE NOVEL "DEATH COMES TO ME FROM SUCH EYES" BY REXHEP QOSJA

Veron DOBROSHI

Universiteti i Prishtinës

Abstrakti

Ky studim do të thellohet në strukturën e ndërlikuar narrative dhe thellësinë tematike të romanit të Rexhep Qosjes "Vdekja më vjen prej syve të tillë" të Rexhep Qosjes, duke u fokusuar në ndërveprimin midis shtresave kohore dhe reflektimeve hapësinore. Nëpërmjet portretizimit të jetës së Xhezair Gjikes në Vajazan, Qosja përdor teknika narrative që ofrojnë këndvështrime të ndryshme. Studimi eksploron se si autori i bashkon këto perspektiva për të ndriçuar thelbin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe mjedisin socio-kulturor. Përshkrimi i kohës dhe hapësirës nga Qosja shërben si një mjet narrativ për të eksploruar temat e identitetit, kujtesës dhe reflektimit ekzistencial. Personazhi shqyrtohet në lidhje me mjediset fizike dhe kohore që formësojnë jetën dhe perceptimet e tij. Shtresat e ndërthurura kohore dhe reflektimet hapësinore në roman janë esenciale për të kuptuar zhvillimin e protagonistit dhe gjendjen individuale dhe kolektive në kontekstin social të ngjarjeve që rrëfohen në njërin prej romaneve më të rëndësishme të letërsisë shqiptare të shekullit XX.

Metodat

Studimi përdor një analizë duke u mbështetur në teori të tilla si koncepti i Mikhail Bakhtin për kronotopin nocionin e Michel Foucault për heterotopinë si dhe teoritë tjera mbi hapësirën, kohën dhe rrëfimin për të interpretuar ndërlidhjen e kohës me hapësirën në roman. Studimi gjithashtu mbështetet në teknikat dhe simbolikën e rrëfimit postmodern për të eksploruar zhvillimin e personazheve dhe reflektimet socio-historike.

Fjalët kyçe: koha, hapësira, personazhi, letërsia, shqiptare

Abstract

This study will delve into the complex narrative structure and thematic depth of Rexhep Qosja's novel "Death comes from such eyes" by Rexhep Qosja, focusing on the interplay between temporal layers and spatial reflections. Through the portrayal of Xhezair Gjika's life in Vajazan, Qosja uses narrative techniques that offer different perspectives. The study explores how the author brings these perspectives together to illuminate the essence of interpersonal relationships and the socio-cultural environment. Qosja's depiction of time and space serves as a narrative tool to explore themes of identity, memory, and existential reflection. Character is examined in relation to the physical and temporal environments that shape his life and perceptions. Interwoven time layers and spatial reflections in the novel are essential to understanding the development of the protagonist and the individual and collective situation in the social context of the events narrated in one of the most important novels of Albanian literature of the 20th century.

Keywords: time, space, character, literature, Albanian

Krijimtaria e Rexhep Qosjes

Rexhep Qosja është njëri nga shkrimtarët, intelektualët, publicistët më të njohur shqiptarë që me veprën e tij e ngriti në një nivel edhe më të lartë kulturën dhe letërsinë shqiptare. Vepra letrare e Qosjes e pasuron këtë letërsi në rrafsh të ndryshme duke e bërë shumëdimensionale dhe duke tërhequr vëmendje për ta studiuar në aspekte të ndryshme. Qosja është autor i shumë veprave në prozë, dramë, kritikë letrare, publicistikë e sprova të ndryshme. Ai është një nga figurat e çmuara të kombit shqiptar, i cili është marrë thellësisht me studimin e letërsisë, historisë e kulturës shqiptare ndër vite.

Vdekja më vjen prej syve të tillë

Ky është njëri nga romanet më të njohura të Qosjes dhe më i veçanti për nga plani artistik e tematik. Romani është konsideruar edhe si një nga veprat e para postmoderne të letërsisë shqiptare. Vdekja më vjen prej syve të tillë është botuar fillimisht në vitin 1974 nga Rilindja në Prishtinë. Vecoritë artistike të rrëfimit, narracioni, teknikat e ndryshme postmoderne janë disa nga karakteristikat që e bëjnë romanin të cilësohet si i tillë. Ngjarjet e romanit zhvillohen në toposin e emërtuar Vajazan dhe për personazhin me emrin Xhezairi i Gjikës. Autori luan në mënyrë alegorike e simbolike me elementet e hapësirës e të kohës dhe siç shprehet studiuesi Mikhail Bakhtin "Do t'i japim emrin kronotop (fjalë për fjalë, "kohë-hapësirë") lidhjes së brendshme ndërmjet marrëdhënieve kohore dhe hapësinore që shprehen artistikisht në letërsi." (Bakhtin, 1981). Në nëntekstin e romanit zbulojmë që koha e ngjarjeve lidhet me realitetin e vështirë të shqiptarëve gjatë viteve të pas luftës së dytë botërore në Kosovë, në kohën e sundimit jugosllav dhe raporteve të vështira mes shqiptarëve dhe regjimit të ish-jugosllavisë.

Ndërveprimi i kohës dhe hapësirës në roman

Romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë" me teknikat narrative dhe përshkrimet artistike e alegorike, bën ndërlidhjen e kohës dhe hapësirës duke e lidhur me gjendjen shpirtërore dhe ekzistenciale të personazheve, por gjithnjë nga fokusi i Xhezairit të Gjikës, protagonistit kryesor të romanit. "Në tregim, ku hapësira lidhet me personazhet që e "jetojnë" atë, aspekti kryesor i hapësirës është mënyra se si personazhet i japin ndjesitë e tyre hapësirës. Tri ndjenja janë veçanërisht të përfshira në përfaqësimin perceptual të hapësirës: shikimi, dëgjimi dhe prekje. Të tria marrin pjesë në paraqitjen e një hapësire në tregim" (Bal, 2009). Studiuesi frëng Michel Foucault flet për termin heterotopi kur i referohet botës së hapësirës; "Me heterotopi, Foucault nënkupton bashkëekzistencën në një "hapësirë të pamundur" të një "numri të madh botësh të mundshme të fragmentuara" ose, më thjesht, hapësirash të pakrahasueshme që janë vënë pranë njëra-tjetrës ose mbivendosur mbi njëra-tjetrën" (Harvey, 1989). Në romanet postmoderne teknikat narrative i kundërvihen shkrimit të mëparshëm modernist dhe kjo duket në shumë aspekte brenda shkrimit. Ngjashëm ndodh edhe me shkrimtarët që preferojnë të luajnë me elementet e kohës dhe të hapësirës. Sipas David Harvey, mbi të gjitha, postmodernistët largohen në mënyrë radikale nga konceptimet moderniste për mënyrën e trajtimit të hapësirës (Harvey, 1989). Romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë" shtrihet në një rrafsh kohor të pas luftës së dytë botërore, ku në mënyrë alegorike pasqyrohen gjendja dhe vetëdija kolektive e popullit shqiptar të Kosovës në raport me regjimin e asaj kohe. Personazhet e romanit janë ndërthuar si rezultat i ndërveprimit të tyre me kohën dhe hapësirën. Kujtimet e narratorit për fëmijërinë e Xhezair Gjikës nxjerrin në pah sesi ndërthuret identiteti personal me legendat dhe peizazhet e Vajazanit.

Reflektimet e hapësirës përmes gjuhës dhe veprimit të personazheve

Hapësira në një roman përbën boshtin kryesor ku veprojnë personazhet. “S’ka ngjarje pa vend. Të gjithë e kanë vendin e vet. Por, hapësira nuk është vetëm ajo ku ndodh ngjarja, por s’ka ngjarje jashtë hapësirës” (Apolloni, 2012). Në romanin e Qosjes Vajazani del paraqitet si një vend ku ndodhin ngjarjet e romanit dhe *vend quhet vetëm ajo pjesë ku ndodh ngjarja* (Apolloni, 2012). Vajazani është një jehonë e përvojave dhe përjetimeve ekzistenciale. Është një topos që formësohet nga lëvizjet, veprimet dhe perceptimet e personazheve.

Hapësirat e paraqitura duke përfshirë Vajazanin, shpellën e Harapit, varrin e Kopilit e të tjera, por edhe hapësira të brendshme si dhoma e protagonistit, si shërbejnë si pasqyra e konflikteve të brendshme dhe dinamikave shoqërore. Vajazani në roman pasqyrohet me kontekstin historik dhe rëndësinë kulturore që bart prapa vetes, vendbanimin e shqiptarëve në atdhe, por të cenuar nga liria dhe regjimi jugosllav i kohës. Përshkrimet e këtyre hapësirave dhe reflektimet e tyre ndërthurin mitin me folkloristikën, përrallat e vjetra shqiptare, zakonet dhe besimet e ndryshme. Nuk mungon as pjesa e përshkrimit të hapësirës së brendshme si shtëpia dhe dhoma e personazheve. “Një shtëpi përbën një trup imazhesh që i japin njerëzimit prova ose iluzione të qëndrueshmërisë. Ne jemi vazhdimisht duke ri-imagjinuar realitetin e saj: të dallosh të gjitha këto imazhe do të nënkuptonte përshkrimin e shpirtit të shtëpisë; do të thoshte zhvillimin e një psikologjie të vërtetë të shtëpisë” (Bachelard, 1994). Personazhet në këtë roman janë të ndërtuar duke u përshkruar në detaje për ambientin ku ata banojnë, duke e paraqitur me përshkrime plot finesë, me toponime që gjithnjë dalin në terma simbolikë. Ja se si duket një rast nga tregimi Trilogjia brenda romanit:

Banonte në katin përdhes të një ndërtese të madhe, dhjetëkatëshe, që kishte nëntë hyrje, që në secilën hyrje kishte nga tridhjetë banesa, një dhe dydhomëshe dhe që gjendjen në Rrugën e herojve të paqes, ku edhe s’kishte godina të vogla (Qosja, 1980).

Vajazani si hapësirë mitike: trauma historike dhe luftime personale

Vajazani në roman shfaqet si një hapësirë me shumë plane. Nuk është thjesht një vendndodhje fizike, por një entitet dinamik dhe simbolik që lidhet me konfliktet e brendshme dhe të jashtme të personazheve. “Çdo rrëfim duhet të krijojë rrëfime të reja: brenda vetvetes, me qëllim që personazhet të kenë mundësi të jetojnë” (Todorov, 2000). Vajazani ka edhe tipare mitike, duke përzier realitete të fragmentuara dhe botë fikzionale, duke kujtuar nocionin e Foucault kur fliste për heterotopinë, një hapësirë ku bashkëjetojnë realitete të pakrahasueshme. “Mund të dallohen dy lloje kryesore të hapësirës mitike. Në njërin rast, hapësira mitike është një zonë e mjegullt e njohurive të paplota që rrethon atë që njihet empirikisht; ajo përfshin hapësirën pragmatike. Në rastin tjetër, është komponenti hapësinor i një botëkuptimi, një konceptim i vlerave të lokalizuara brenda të cilave njerëzit zhvillojnë aktivitetet e tyre praktike” (Yi-Fu Tuan, 1977). Kjo ndërthurje dinamike e hapësirave brenda Vajazanit lidh realen me mitiken, duke krijuar një mjedis që është njëkohësisht strehë e rregullt, por edhe vend i kaosit. Hapësirat mitike shërbejnë si topose alegorike që në nëntekst zbulojnë vendin e lirë që reziston ndaj të huajës, rrezikut për të ardhmen. Legjenda e Shpellës së Harapit ilustron se si e kaluara bëhet një forcë aktive në formësimin e perceptimeve dhe dëshirave të tanishme. Dështimet e përsëritura të banorëve të qytetit për të marrë thesarin dhe ciklin e shpresës dhe dëshpërimit demonstrojnë këmbënguljen dhe ambicien e vazhdueshme njerëzore. Në tregimin e titulluar “Mëkata” kujtimet e Xhezairit të Gjikës zhvillohen përmes shtresave kohore në tri periudha të ndryshme, e kaluara, e sotmja dhe e ardhmja. Këtu kohën simbolike e përfaqëson vjeshta, stinë e vitit që këtu reflekton ndryshimin, shembjen, vdekjen. *Vjeshta e vdekur shëtiste rrugëve të Vajazanit.* (Qosja, 1980).

lidhje të tilla simbolike krijojnë edhe personazhet tjerë sic është për shembull Lec Paçarri, ku shpaloset gjendja e tij ankthioze dhe netët pa gjumë, një formë e lidhjes së personazhit me kohën dhe hapësirën në të cilën gjendet personazhi dhe pvrjetimet e tij. Ato plotësohen edhe me hapësirat tjera si shtëpia, dyqani, xhamia, rrugët dhe elemente tjera hapësinore.

Lidhjet e mjedisit kohor me kujtesën kolektive

Kujtesa luan një rëndësi të madhe në veprat letrare dhe ky aspekt në romanin e Qosjes shfaqet në trajta kolektive. “Efekti i letërsisë në kulturën e kujtesës qëndron në ngjashmëritë e saj dhe dallimet në proceset e të kujtuarit dhe të harruarit. Para së gjithash, letërsia dhe kujtesa shfaqin disa ngjashmëri të dukshme. Këto përfshijnë formimin e "figurave të kujtesës" të kondensuar dhe një tendencë drejt krijimit të kuptimit përmes narrativizimit dhe modeleve të zhanrit” (Erll, 2011). Koha manifestohet në forma të kujtesës së përsëritur të popullit të Vajazanit, që simbolizon kujtesën kolektive të shqiptarëve nën sundimin ish-jugosllav. Në tregimin me titull “Trashja” duket relacioni i kësaj kujtese që shfaqet në rrëfimin e narratorit, duke ndërtuar të tashmen dhe rindërtimin e jetës së Trashjes. Trashja pasqyron plagët fizike dhe metaforike të mjedisit të saj.

Atë ditë e sot më kujtohet Trashja e Dervishit të Mukailit dhe më del para syve e gjallë, shishmane, e leckosur si është më zi, por edhe e mavijosur, e vdekur, e shtrirë mbi një varr të vockël, që akoma e quajnë Varri i Kopilit (Qosja, 1980).

Ky është fillimi i tregimit “Trashja”. Përsëritja kohore e kujtimeve ndërvepron me hapësirat alegorike. “Hapësira përjetohet drejtpërdrejt si një vend ku mund të lëvizet. Për më tepër, duke kaluar nga një vend në tjetrin, një person fiton një ndjenjë drejtimi” (Yi-Fu Tuan, 1977). Nga fragmenti sic mund të shihet, përmendet varri i kopilit, si një vend ku fshatarët e kërkojnë thesarin e fshehur. Hapësirat e tilla janë mjaft të dendura në këtë roman dhe përfaqësojnë dicka shumë më të thellë se një emër, se një varr. Varri i Kopilit ndryshe mund të shihet si vendi i thesarit, por që në thelb përfaqëson pronësinë, të fshehtë që s’mund ta kenë të tjerët. Këtu gërshetohen ngjarjet e së shkuarës, që lidhen me figurën e Trashjes, bashkë me të tashmen reflektuese të Xhezairit të Gjikës, por edhe të personazheve të tjerë.

Hapësira, koha dhe identiteti shqiptar nën sundimin jugosllav

Hapësira dhe koha mishërohen për të krijuar kujtime të shtresuara, duke pasqyruar si përvojat individuale të personazheve, ashtu edhe realitetin më të gjerë social-politik të shqiptarëve nën sundimin jugosllav. *Hapësira dhe koha, të alternuara, krijojnë ritmin e rrëfimit.* (Apolloni, 2012).

Dimensioni hapësinor në roman - i paraqitur me emra vendesh si Vajazani – arrin të bëhet një fushë dinamike ku historia, miti dhe kujtesa bashkohen. “Vendi është një lloj i veçantë objekti. Ai është një përqendrim vlerash, megjithëse jo një gjë e vlerësuar që mund të trajtohet ose të bartet lehtësisht; është një objekt në të cilin mund të banohet” (Yi-Fu Tuan, 1977).

Koha, nga ana tjetër, është e fragmentuar dhe jolineare, duke i bërë jehonë stilit narrativ postmodern dhe duke pasqyruar jetesën dhe rezistencën nën një regjim shtypës. Vajazani, me cilësitë e tij mitike dhe heterotopike, bëhet një vend ku e kaluara dhe e tashmja bashkëjetojnë, ku personazhet përballen me peshën e padrejtësive historike, përderisa përballen me betejat e tyre personale. Ky ndërveprim zbulon çorientimin dhe tjetërsimin që përjetojnë individët, identitetet e të cilëve janë mes trashëgimisë kulturore, zakoneve dhe besimeve të vjetra të popullit shqiptar dhe nënshtrimit politik. Koha në këtë roman gërsheton kujtimet personale me kujtesën kolektive të shqiptarëve gjatë kësaj epoke. Shkrimi e kohës dhe hapësirës i lejon

personazhet të përjetojnë momente zbulimi, ku krizat e tyre personale kontekstualizohen brenda kornizës më të madhe të vuajtjes historike dhe qëndrueshmërisë kulturore. Hapësira dhe koha shërbejnë jo vetëm si mjete narrative, por si metafora për kompleksitetin e ekzistencës nën sundimin jugosllav, duke zbuluar shpirtin e thyer por të qëndrueshëm dhe të palëkundur të popullit shqiptar.

Rezultatet

Ndërveprimi i kohës dhe hapësirës në roman pasqyron betejat e brendshme të protagonistit Xhezair Gjika dhe ndërveprimet e tij me mjedisin e tij socio-historik. Përshkrimi i Vajazanit, si hapësirë fizike dhe simbolike, zbulon shtresa të traumës historike dhe kujtesës kolektive, duke ndërthurur mitin, folklorin dhe temat ekzistenciale.

Struktura narrative përdor shtresa të fragmentuara kohore për të lidhur identitetin personal të protagonistit me kujtesën kolektive të popullit shqiptar në Kosovë gjatë një periudhe të shtypjes politike. Hapësira, e përfaqësuar përmes mjediseve të ndryshme simbolike e alegorike dhe hapësirat e brendshme, funksionon si një pasqyrë për konfliktet emocionale dhe ekzistenciale të personazheve, duke nxjerrë në pah tensionin midis qetësisë dhe kaosit.

Përfundim

Romani ilustron se ndërveprimi hapësinor-kohor shërbejnë si mjete për të eksploruar temat e identitetit, kujtesës dhe ndërgjegjes historike. Duke pasqyruar betejat personale të protagonistit brenda realiteteve më të gjera socio-politike, Qosja krijon një rrëfim shumëdimensional që qëndron si një kontribut i rëndësishëm në letërsinë dhe kulturën shqiptare. Ky studim nënvizon rëndësinë e shqyrtimit të letërsisë përmes domeneve të kohës dhe hapësirës për të kuptuar më mirë thellësinë e saj kulturore dhe ekzistenciale.

Referencat

- [1]. Apolloni, A. (2012). *Paradigma e Proteut*. OM.
- [2]. Bachelard, G. (1994). *The Poetics of Space*. Beacon Press.
- [3]. Bakhtin, M. (1981). *Dialogic Imagination: Four Essays*. University of Texas Press.
- [4]. Harvey, D. (1989). *The Condition of Postmodernity: An Enquiry into the Origins of Cultural Change*. Blackwell Publishers.
- [5]. Erll, Astrid. (2011). *Memory in Culture*. Palgrave Macmillan.
- [6]. Qosja, R. (1980). *Vdekja më vjen prej syve të tillë*. Rilindja.
- [7]. Todorov, T. (2000). *Poetika e Prozës*. Panteon-Shtëpia e Librit.
- [8]. Tuan, Y. (1977). *Space and place: The perspective of Experience*. University of Minnesota Press.